

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës – Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Shërbim mirëmbajtje për pajisjet e kondicionimit”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

45331000-6 - Punime ngrohje, ventiliimi dhe kondicioneresh

VLERA E FONDIT LIMIT:

Vlera e pritshme e kontratave (Fondi limit):

Fondi limit: 2 603 460 (dy milion e gjashtëqind e tre mijë e katërqind e gjashtëdhjetë) **Lekë pa TVSH**

Shumatore e çmimeve për njësi: 179 800 (njëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e tetëqind) **Lekë pa**

TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Perlllogaritja e fondit limit është kryer mbështetur në nenet 12 dhe 13 të VKM nr 285 date 19.05.2021, në Udhezimin nr 30 date 27.12.2021 ” Mbi menaxhimin e aktiveve në njesite e prokurimit publik”, të ndryshuar Kapitulli II , pika 23, mbi bazën e studimit të tregut nga struktura e ngritur nga AK për këtë qëllim, duke iu drejtuar 3 operatoreve ekonomike në treg që operojnë në fushën e këtij objekti prokurimi, pasi nuk egzistojnë çmime reference zyrtare për këto lloje shërbimesh .

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Operatori ekonomik duhet të dorëzojë kopje të deklaratave të xhiros vjetore ose vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore, për xhiron e realizuar **në tre vitet e fundit (2019, 2020, 2021)** vlera mesatare e të cilës të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit.

2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë **3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**, jo më të vogël se 20 % të vlerës së përlogaritur të kontratës (fondi limit).

Këto shërbime të ngjashme duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a) Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga institucioni shtetëror ose faturat tatimore ku të shënohen datat, shumat dhe shërbimet e kryera.
- b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi do të pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi Ligjor : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe Nenit 43 pika 2/c dhe pika 3 VKM 285 dt 19.05.2021 te ndryshuar

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Argumentimi i AK : Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e xhiros është vendosur që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin Nr.8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formes elektronike".

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare _____, të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar,

vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të (shëno bazën ligjore), ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

(Shënim: ky kriter vendoset vetëm në rastet kur vlerësohet nga autoriteti/enti kontraktor)

Nuk është aplikuar nga AK.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, _____ (Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese).

Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.1.1. Licenca lidhur me ekzekutimin e punimeve:

a. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të zotërojë licencë profesionale e cila të përmbajë kategoritë, sipas modelit të lëshuar nga MPPT:

NS – 12 (A) Impiante teknologjik, termike dhe të kondicionimit.

2.1.2 Përsa i përket aftësisë teknike dhe profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të vendosura nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:

a. Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë pajisur me Çertifikatën ISO 9001:2015 ose ekuivalente, lidhur me sistemin e menaxhimit të cilësive, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme. (dokumentacioni të paraqitet në gjuhën shqipe ose i përkthyer dhe e noterizuar).

Enti certifikues për lëshimin e certifikatave ISO të kërkuara për operatorin ekonomik ofertues të jetë i njohur nga Drejtoria e Akreditimit Shqiptar. Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike certifikatat janë të detyrueshme për të gjithë operatorët sipas llojit dhe sasisë së shërbimeve

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, sipas nenit 88 të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikatën ISO sipas zërave të punëve/mallrave/shërbimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas aktmarrëveshjes.

Argumentimi: Në bazë të Neni 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve, pika 4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; si dhe në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 pika 2 c) të LPP, nenin 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Ky kriter është vendosur në përmbushje të detyrimeve ligjore që përcaktojnë Ligji nr.116/2014, datë 11.09.2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të Konformitetit”,

2.3 Kapaciteti teknik:

2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë **3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**, jo më pak se 20 % të vlerës së përlogaritur të kontratës (fondi limit).

Këto shërbime të ngjashme duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- c) Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga institucioni shtetëror ose faturat tatimore ku të shënohen datat, shumat dhe shërbimet e kryera.
- d) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi do të pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 55, pika 4, b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 15 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

3. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të kenë në stafin e tyre staf të kualifikuar dhe specialistët e domosdoshëm për të realizuar objektin e këtij prokurimi si mëposhtë:

2.1. Dëshmi për fuqinë mesatare punëtore të operatorit ekonomik:

a. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë në stafin e tyre dhe të figurojnë si drejtues teknik në licencën e shoqërisë si dhe në listëpagesat e shoqërisë për periudhën minimumi Nëntor-Dhjetor 2022:

- 1 (një) drejtues teknik ing. Elektrik

Drejtuesit teknike të kërkuar me sipër bazohen në shërbimet mirëmbajtëse specifike që kërkohen.

b. Disponimi i specialistëve teknikë për objektin e këtij prokurimi

Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë specialiste të fushës që figurojnë në listëpagese të pakten 2 muajt e fundit me kodet përkatëse sipas profesioneve të punës minimumi:

- 2 (dy) teknik sistem ngrohje
- 1 (një) elektromekanik
- 1 (një) elektrikist

si dhe të dëshmojë që ka staf të kualifikuar. Për këto të paraqesë dëshmi kualifikimi për punonjës të tjerë të stafit si:

- 1 (një) specialiste ngrohje-ftohje të pajisur me dëshmi kualifikimi nga organizëm i akredituar në Shqipëri

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 41, pika 4/ b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët

ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Ky numer minimal është kërkuar duke u bazuar në numrin e automjeteve që kanë nevojë për kryerjen e shërbimeve si dhe natyrën dhe numrin e shërbimeve që kërkojnë. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, numri i punonjesve të kërkuar, në bazë të kërkesës së Autoritetit Kontraktor, për realizimin e objektit.

2.1 c. Operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë “Dokumentin e Vlerësimit të Riskut (DVR)”, në pajtim me Ligjin Nr.10237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe Shëndetin në Punë”, i ndryshuar, sipas fushës së objektit të veprimtarisë. (në rast bashkimi operatorësh ekonomike, mjafton disponueshmëria e 1 DVR për të gjithë BOE).

Argumentimi: Në bazë të Neni 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave, pika 7. Për të provuar se operatori ekonomik vepron konform kërkesave të legjislacionit në fuqi, autoriteti/enti kontraktor kërkon që:

c) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës.

4. Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të disponojë të paktën:

1 (një) automjet për transportin e mallrave, të cilat duhet t'i ketë në pronësi/me qira/mbështetje nga një operator ekonomik për të paktën 1 (një) automjet për transportin e mallrave;

2 (dy) motocikleta për riparimet emergjente.

Për vërtetimin e kësaj kërkesë duhet të paraqesë, Leje Qarkullimit, sigurimin e detyrueshëm të mjeteve, Akt-kontrollin teknik (Kolaudimin) të vlefshme), ose në rast se nuk i ka në pronësi të paraqesë kontratën e qirasë ose një deklaratë mbështetje nga një operator ekonomik ku të deklarohet se mbështetja e tij për këtë kapacitet teknik ofrohet për një afat sa kohëzgjatja e kontratës së parashikuar si dhe dokumentacionin shoqërues për qarkullimin e mjeteve të kërkuara (Leje Qarkullimi, sigurimin e detyrueshëm të mjeteve, akt-kontrollin teknik (Kolaudimin) të vlefshme).

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

.....
(Shënim- shtoni argumentimin nga ana teknike për nevojën për mjetet dhe pajisjet e kërkuara, për realizimin e kontratës).

Shënim: Autoretiti /enti kontraktor mund të kërkojë edhe:

2.3. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1.....

(Shënim: Autoriteti/enti kontraktor, në varësi të natyrës së objektit të prokurimit, mund të përcaktojë kritere të tjera të vecanta, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës, duke argumentuar teknikisht dhe ligjërisht çdo kriter, duke përcaktuar, sipas rastit, aktin ligjor/nënligjor që parashikon domosdoshmërinë e kriterit në fjalë).

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Argumentimi ligjor : Parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Argumentimi i AK: Gjate hartimit te specifikimeve teknike dhe termave te references AK i eshte referuar dhe bazuar në VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit public. Objektit i procedures është specifik dhe është e para që zhvillohet me mjete elektronike prandaj mungonte mundësia e referimit të eksperincës së Autoriteteve të tjera kontraktore. Në përfundim duke u bazuar në inventarin ekzistues, studimit të tregut dhe sipas manualeve të secilës markë të sobave që janë objekt mirëmbajtje u hartuan specifikimet teknike dhe termat e references.

AK ne asnje rast nuk ka përdorur emra markash/standartesh por në përgjithsi njofton se janë në inventar mirëmbajtjeje pothuaj të gjithë market e tregtuara në vendin tonë dhe ne cdo rast standartet apo kerkesat e performances jane shoqeruar me fjalet “ose ekuivalent”.